

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje pajisje orendi”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 30190000-7 -
Furnizime dhe pajisje të ndryshme zyre

VLERA E FONDIT LIMIT: 1 319 461 *(një milion e treqind e nëntëmbëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e një) Lekë pa Tvsh.*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikaten ISO 9001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së.

2.1.2 Organi i vlerësimit të konformitetit të certifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues duhet të jetë i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 pika 2 c) të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Ky kriter është vendosur në përmbushje të detyrimeve ligjore që përcaktojnë Ligji nr.116/2014, datë 11.09.2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të Konformitetit", Ligji nr.10489 datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", VKM nr. 667, datë 29.7.2015 "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, ndërsa kushti që *bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar është vendosur në zbatim të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar"* i ndryshuar.

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2025 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2025 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore”i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara, b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” në kushtet kur kjo procedurë prokurimi klasifikohet procedurë e hapur e thjeshtuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Në zbatim të nenit 55, pika 4/b në kushtet kur kjo procedurë prokurimi është procedurë e thjeshtuar të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: *Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik. Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për mallra të cilat ndihmojnë Autoritetin Kontraktor në proceset e punës për kryerjen e detyrave funksionale. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 6 të Dokumentave Standarte të Tenderit.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.